Administratorët e rrjetit duhet të kenë mundësi të monitorojnë nëpërmjet grupimeve të

aplikacioneve apo planifikimin e tyre, sipas nevojave të përdoruesve.
Zgjidhja të ofrojë monitorim midis dy site-ve bazuar në adresat IP, prej te cilave mund te shikohet qartësisht përdorimi i bandwidth-it, shpejtësia, paketat e transportuara bazuar në grupime IP, përdorimi i aplikacioneve, burimi dhe destinacioni i ngjarjeve të përmenduara bazuar në grupet IP.
Dashboard të personalizueshëm si: shtimi i pajisjeve on top të infrastrukturës, ndërfaqeve, grupim të ndërfaqeve, grupe IP bazuar në shpejtësi, vëllim, përdorim etj.
Zgjidhja duhet të gjenerojë alerte të sistemit 24x7 për ngjarjet, të cilat thyejnë rregullat e vendosura nga administratorët e sistemit si: vendosja e limit të përdorimit të bandwidth-it, shpejtësia e transmetimit, afatet kohore të njoftimit apo përshtatja e sistemit për të gjeneruar alerte.
Zgjidhja të jetë plotësisht e integrueshme me Cisco Application Visibility and Control duke gjeneruar raporte: NBAR2 application reports, URL hit count, QoS class hierarchy, ART monitoring.
Zgjidhja duhet të ofrojë funksionalitete si: zgjidhje të shpejtë të problemeve pa afektuar punën e përdoruesve, klasifikim të trafikut, vizibilitet të trafikut në nivel layer 7, përmirësim të performancës së trafikut për aplikacionet kritike të biznesit.
Zgjidhja duhet ofroje mundesi monitorimi nga pajisje mobile.
Zgjidhja te ofroje raporte bazuar ne parametra kritike si: Jitter, Packets Lost, Round Trip Time.
Specifikimet teknike minimale të hardware dhe software: processor min. 2.4 GHz quadcore, min. 4 GB memory , min. 200 GB kapacitet i mbrojtur, 64-bit operating system, Linux, Windows Server 2012 dhe më të ri, SQL 2012 dhe më ri.
Në zgjidhje të përfshihet licensimi i përhershëm për një periudhe 1 vjeçare.

2.7 FV. Software për videokonferencë dhe online meeting

Karakteristikat e kërkuara
Zgjidhja duhet të ofrojë takime online per konferenca audio, video dhe web për individë, departmente apo kompani.
Zgjidhja të menaxhohet nga të paktën një përdorues.
Zgjidhja të përfshijë mbi 100 pjesëmarrës me audio për takim online.
Zgjidhja duhet të ofrojë minimalisht 20 pjesëmarrës me video dhe audio.
Pjesëmarrësit duhet të kenë mundësi të bëhen pjesë e takimit online nga çdo vendndodhje që ka qasje në internet.
Zgjidhja të ofrojë opsione audio si: SIP, VoIP, çdo telefon PSTN.
Zgjidhja duhet të ofrojë chat për çdo pjesëmarrës individualisht si edhe chat për të gjithë pjesëmarrësit.
Zgjidhja duhet të ofrojë fleksibilitet në përdorimin e platformes për: mbledhje, trajnime, event apo support.
Zgjidhja të ofrojë minimalisht 20 Gb kapacitet për ruajtjen e skedarëve dhe min. 10 Gb për recording.

Zgjidhja të ketë mundësi të rregjistrojë takimin online, si edhe të rishikojë dhe ndajë përmbajtjen e takimit.
Zgjidhja të ofrojë hapësirë pune të sigurtë, ku secili mund të kontribuojë në çdo kohë me mesazhe, audio, video, thirrje.
Zgjidhja të ketë mundësi të integrohet me asetet IT ekzistuese si: shërbimi i thirrjeve, shërbimi kalendarik, direktori shërbimesh, video, siguria e të dhënave.
Zgjidhja të përfshijë licencë të pajtueshme për një periudhë 1 vjeçare.

2.8 FV. Platforma e lëvrimit të aplikimeve.

Zgjidhja të ofrohet si një platformë fizike e gjeneratës së fundit me shërbimet më inovative në fushën e sigurisë dhe lëvrimit të aplikimeve.

Zgjidhja duhet të suportoje funksionalitetet e mëposhtme:

- FastView Web Performance Optimization
- Application Performance Monitoring
- Web Application Firewall
- Authentication Gateway
- Advanced Denial of Service.

Zgjidhja duhet të ofrohet si pay-as-you grow me throughput minimalisht 6Gbps dhe të ketë mundësi të ofrojë nëpërmjet licensave shtesë deri në 26 Gbps pa rritur kapacitetet e hardware.

Zgjidhja të ofrojë 5 virtual load balancer dhe të ketë zgjerueshmëri deri në 24 nëpërmjet licencës.

Të paktën 630k lidhje/sekondë në Layer 4.

Të paktën 850k lidhje/sekondë në Layer 7.

Zgjidhja të ofrojë performancë të lartë SSL me standarde më të fundit RSA (CPS) 2k keys

- Të paktën 600 lidhje SSL/sec 2k Keys.
- Të paktën 2k throughput SSL 2k keys.
- Enkriptim trafiku 10 Gbps.

Zgjidhja duhet të ofrojë izolim të plotë mes shërbimeve virtuale, për të ofruar SLA të ndryshme të aplikimeve të lëvruara.

Zgjidhja të ofrojë monitorim fleksible dhe të avancuar të aplikimeve si dhe ridrejtimit trafiku në layer 4 deri në 7.

Të suportoje funksionalitet DR/BCC nëpërmjet funksionalitetit “global server load balancing”.

Zgjidhja të suportoje në HA mode/Cluster

Zgjidhja duhet të suportoje funksionalitet për optimizim Link-u / multi-homing

Të ofrojë server offloading nëpërmjet akselerimit SSL, agregimit dhe kashimit TCP.

Të ofrojë performancë të shpejtë të aplikimeve të prezantuara duke përdorur kompresim dhe optimizim TCP.

Të ofrojë menaxhim të bandwidth të secilit aplikacion nëpërmjet teknikave rate shaping.

Zgjidhja e propozuar duhet të ketë aftësinë për të konfiguruar shërbime të shumëfishta në të njëjtën IP virtuale me porta të ndryshme.

Algoritmi i Load Balancing duhet të ofrojë minimalisht funksionalitet perkatës ip based persistency, session-based cookie persistency and headers inspection, url redirection, hash ip, round robin, shortest repose time and least connections

Zgjidhja duhet të ofrojë monitorim dhe raportim në kohë reale

Pajisja duhet të aksesohet nepermjet SSH, HTTPs dhe CLI

Loget HTTP mund të konfigurohen në pajisjen me opsione si url, header, referrer, source and destination servers

Zgjidhja të bëjë detektim të errësive në kohë reale – tracking deri në përfundim të transaksionit.

Zgjidhja të ofrojë monitorim të SLA-së të aplikacioneve dhe përgjigjes të çdo transaksioni user-i

Zgjidhja të ofrojë protokolle rutimi OSPF, RIP, RIP II, BGP.

Zgjidhja duhet të ketë të përfshirë:

- Të paktën 8 x 1GbE RJ45 porta trafiku.
- Të paktën 2 x SFP+ 10G porta me module SR multimode
- Të paktën një procesor quad-core.
- Të paktën 32 GB memorje RAM.
- Të paktën 500 GB SSD drive.
- Të paktën një portë USB për instalimin dhe rikthimin e software.
- Të paktën një portë seriale menaxhimi RJ45.
- Pajisja të përfshijë fane Front to Back.
- Pajisja të përfshijë dy power supply redundante.

Suporti dhe implementimi

Në zgjidhje të përfshihet suporti për update të software për 1 vit me nivel kontrate shërbimi 24x7x4.

Në zgjidhje të përfshihet suporti nga vendori për riparim në vendin e instaluar të pajisjes nën suporti dhe garanci.

Instalimi, konfigurimi dhe testimi duhet të bëhet nga ofertuesi, zgjidhja duhet të dorëzohet e plotë (Turnkey Solution)

Zgjidhja të ofrojë mundësi për të parë dhe hapur trouble ticket me qendren suporti e autorizuar të prodhuesit të pajisjes.

2.9 FV. Upgrade, Kartë Uplink me 4 porta GE SFP+.

OSHEE Group sh.a. kërkon të bëjë upgrade me module uplink për switchet ekzistues Cisco 3850.

- Moduli uplink duhet të kenë 4 porta GE SFP+
- Garancia e ofruar nga prodhuesi duhet të jetë për një periudhë 1 vjeçare.

2.10 FV. Upgrade, Kartë rrjeti me 8 porta GE.

OSHEE Group sh.a. kërkon të bëjë upgrade me module rrjeti për Ruterat ekzistues Cisco 2921.

- Moduli rrjeti duhet të kenë 8 porta Gigabit Ethernet.
- Garancia e ofruar nga prodhuesi duhet të jetë për një periudhë 1 vjeçare.

2.11 FV. Modul SFP 10Gbase SR për fibër optike multimode.

OSHEE Group sh.a. kërkon të blejë module Hot-swappable SFP 10Gbase short range për infrastrukturën e rrjetit në data center.

- Moduli 10GBASE-SR duhet të jenë kompatibël për fibër multimode me konektor LC.
- Moduli të ofrojnë vetëm 10GBASE Ethernet.

- Modulet duhet të jenë të reja dhe kompatibël me kartat uplink për switchet ekzistuese Cisco 9200.
- Garancia e ofruar nga prodhuesi duhet të jetë për një periudhë 1 vjeçare.

2.12 FV Modul SFP 10Gbase LR per fiber optike single mode.

OSHEE Group sh.a. kërkon të blejë module Hot-swappable SFP 10Gbase long range për infrastrukturën e rrjetit në data center.

- Modulet 10GBASE-LR duhet të jenë kompatibël për fiber single mode me konektor LC.
- Modulet të ofrojnë vetëm 10GBASE Ethernet.
- Modulet duhet të jenë të reja dhe kompatibël me Switch-et ekzistues Cisco 3850.
- Garancia e ofruar nga prodhuesi duhet të jetë për një periudhë 1 vjeçare.

2.13 FV. Modul SFP BaseT.

OSHEE Group sh.a. kërkon të blejë module Hot-swappable SFP BaseT për infrastrukturën e rrjetit në data center.

- Modulet SFP BaseT duhet të jenë kompatibël për kabëll bakri.
- Modulet të ofrojnë vetëm BaseT Ethernet.
- Modulet duhet të jenë të reja dhe të jenë kompatibël me Switch-et ekzistues Cisco 3850 dhe Cisco 9200.
- Garancia e ofruar nga prodhuesi duhet të jetë për një periudhë 1 vjeçare.

2.14 FV. Modul SFP 1000base per fibër optike multimode.

OSHEE Group sh.a. kërkon të blejë module Hot-swappable SFP 1000base short range për infrastrukturën e rrjetit në data center.

- Modulet 1000BASE duhet të jetë kompatibël për fiber multimode me konektor LC.
- Modulet të ofrojnë vetëm 1000 BASE Ethernet.
- Modulet duhet të jenë të reja dhe të jenë kompatibël me Ruterat e serisë ISR 2900/4000.

Garancia e ofruar nga prodhuesi duhet të jetë për një periudhë 1 vjeçare.

2.15 FV. Ndërtimi i rrjetit LAN në 30 degë

OSHEE Group sh.a. kërkon të ndërtohet rrjeti i brendshëm LAN për 30 degë të saj të pozicionura në Tiranë dhe rrethe. Rrjeti duhet ndërtuar i tillë që secili kabull të jetë end to end. Pra, secili kabull duhet të vijojë nga switch-i deri tek pajisja (PCapo printer) pa u ndërprerë me switch-e të tjerë. Të gjithë kabujt duhet të qepen në patch pannel në rack për secilën degë. Pajisjet që nevojiten për të realizuar të gjithë rrjetin janë si vijon::

LISTA E PAJISJEVE:

Rack 12U	30 copë
PDU per rack ≥ 6 poste shuko	30 copë
Kabull LAN cat5e ftp	3500 mt

Dokumentat standarde të tenderit

Kanalina per kabujt	1000 mt
Patch Pannel cat5e 24 porta	24 copë
Patch Pannel cat5e 48 porta	6 copë
Patch kabull 1mt	500 copë
Panel menaxhim kabujsh	30 copë

LISTA E DEGEVE:

Rajoni	Emërtimi i zyrës
1	KNK Fresku
2	KNK MMame + GO
3	KNK UNaza e Re
4	KNK Laprakë (Kupola)
5	KNK Vorë
6	GO Vorë
7	KNK MShyri +GO
8	KNK QS + Zyra e TL
9	KNK Pegin
10	KNK Prrenjas
11	KNK Librazhd
12	KNK1 Lushnjë
13	KNK FKrujë
14	KNK Krujë
15	Njesia FKrujë
16	KNK Laç
17	KNK Shijak
18	Drejtoria Shkodër
19	Njësia Shkodër
20	KNK1 Shkodër
21	KNK2 Shkodër
22	KNK3 Shkodër
23	Njësia Lezhë
24	KNK Koplik
25	KNK Lezhë
26	Agjencia Shijak
27	GO Golem
28	GO Rrogozhinë
29	KNK1 Fier
30	KNK Gramsh

2.16 FV. Switch i menaxhueshëm 24 porta

Karakteristika Minimale Teknike

Ndërfaqet dhe karakteristikat hardware

Porta 10/100/1000Mbps RJ45 (Auto Negocim /Auto MDI/MDIX)	≥ 24
Porta SFP	Opsionale
Porta Uplink (baker/fiber) 100/1000Mbps SFP Slots	2-4 / Combo Opsionale
Porta Combo	Opsionale
Porta Console RJ-45/RS-232	1
Instalimi në Rack	19'' Rack Mountable

HYRJE "INPUT"

Tensioni Nominal	100~240 V AC
Frekuenca	50/60 Hz

PERFORMANCA DHE FLEKSIBILITETI

Switching Capacity	≥ 48 Gbps
Throughput	≥ 36 Mpps
Flash Memory	128 MB
RAM	512 MB
Jumbo Frame	Opsionale
Tabelë të Adresave MAC	16k
Fan	Opsionale

STANDARDET

IEEE 802.3 - 10BASE-T	Po
IEEE 802.3u - 100BASE-T	Po
IEEE 802.3ab - 1000BASE-T	Po
IEEE802.3z - 1000BASE-X	Po
IEEE 802.3ad - Agregim linku	Po
IEEE 802.3x - full duplex on 10BASE-T, 100BASE-TX, and 1000BASE-T ports	Po
IEEE 802.1d - Spanning Tree Protocol	Po
IEEE 802.1s - multi STP	Po
IEEE 802.1w - RSTP	Po
IEEE 802.1q - VLAN	Po
IEEE 802.1x - Port-based Network Access Control	Po
IEEE 802.1p - QoS Classification	Opsionale

IEEE 802.3af - PoE	Opsionale
IEEE 802.3at - PoE	Opsionale

SISTEMI OPERATIV

Të Jetë i Orientuar për Operacionet LAN	Po
Të Ketë Mundësi për Upgrade	Po

QUALITY OF SERVICE

Priority Queues	Po
Queue Scheduling	SP, WRR

VECORITË NË LAYER 2 DHE 3

IGMP Snooping	V1/V2/V3
Spanning Tree	STP/RSTP/MSTP
LLDP	Po
BPDU Filtering/Guard	Po
Detektim të Loopback	Po
802.3x Flow Control	Po
VLAN	4k, (Voice VLAN Opsional)
Agregim të Linkeve	802.3ad LACP
Adresimi IPv6	Po
Limitim të Shpejtësisë	Port/Flow
Policy-Based Routing (PBR)	Jo
Routimi	Jo

SIGURIA

Access Control List	L2 - L4
TCP/UDP Ports	Po
Protokollin DSCP	Po
Authentication	RADIUS, IEEE 802.1X, Port/MAC, SSH v1/v2, SSL
Storm Control	Broadcast, Multicast, Unicast

MENAXHIMI

Web-based GUI dhe CLI	Po
RS-232 Console / RJ-45 Console	Po
Telnet, SSH	Po
Monitorim të CPU	Po
SNTP	Po
Upgrade të Firmware	TFTP ose ndërfaqes Web
Ekran LED	Opsionale
SNMP v1/v2c/v3	Po
SYSLOG	Po

Periudha e Mbulimit të Garancisë

“Warranty”:

1 Vit

2.17 FV. Switch i menaxhueshëm 48 porta

Karakteristika Minimale Teknike

Ndërfaqet dhe karakteristikat hardware

Porta 10/100/1000Mbps RJ45 (Auto Negocim /Auto MDI/MDIX)	48
Porta SFP	Opsionale
Porta Uplink (baker/fiber) 100/1000Mbps SFP Slots	2-4 / Combo Opsionale
Porta Combo	Opsionale
Porta Console RJ-45/RS-232	1
Instalimi në Rack	19’’ Rack Mountable

HYRJE "INPUT"

Tensioni Nominal	100~240 V AC
Frekuenca	50/60 Hz

PERFORMANCA DHE FLEKSIBILITETI

Switching Capacity	≥ 96 Gbps
Throughput	≥ 70 Mpps
Flash Memory	128 MB
RAM	512 MB
Jumbo Frame	Opsionale
Tabelë të Adresave MAC	16k
Fan	Opsionale

STANDARDET

IEEE 802.3 - 10BASE-T	Po
IEEE 802.3u - 100BASE-T	Po
IEEE 802.3ab - 1000BASE-T	Po
IEEE802.3z - 1000BASE-X	Po
IEEE 802.3ad - Agregim linku	Po
IEEE 802.3x - full duplex on 10BASE-T, 100BASE-TX, and 1000BASE-T ports	Po
IEEE 802.1d - Spanning Tree Protocol	Po
IEEE 802.1s - multi STP	Po
IEEE 802.1w - RSTP	Po

IEEE 802.1q - VLAN	Po
IEEE 802.1x - Port-based Network Access Control	Po
IEEE 802.1p - QoS Classification	Opsionale
IEEE 802.3af - PoE	Opsionale
IEEE 802.3at - PoE	Opsionale

SISTEMI OPERATIV

Të Jetë i Orientuar për Operacionet LAN	Po
Të Ketë Mundësi për Upgrade	Po

QUALITY OF SERVICE

Priority Queues	Po
Queue Scheduling	SP, WRR

VECORITË NË LAYER 2 DHE 3

IGMP Snooping	V1/V2/V3
Spanning Tree	STP/RSTP/MSTP
LLDP	Po
BPDU Filtering/Guard	Po
Detektim të Loopback	Po
802.3x Flow Control	Po
VLAN	4k, (Voice VLAN Opsional)
Agregim të Linkeve	802.3ad LACP
Adresimi IPv6	Po
Limitim të Shpejtësisë	Port/Flow
Policy-Based Routing (PBR)	Jo
Routimi	Jo

SIGURIA

Access Control List	L2 - L4
TCP/UDP Ports	Po
Protokollin DSCP	Po
Authentication	RADIUS, IEEE 802.1X, Port/MAC, SSH v1/v2, SSL
Storm Control	Broadcast, Multicast, Unicast

MENAXHIMI

Web-based GUI dhe CLI	Po
RS-232 Console / RJ-45 Console	Po
Telnet, SSH	Po
Monitorim të CPU	Po
SNTP	Po

Upgrade të Firmware	TFTP ose ndërfaqes Web
Ekran LED	Opsionale
SNMP v1/v2c/v3	Po
SYSLOG	Po
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit


Vërejtje: Pajisjet duhet të jene kompatibel dhe te integrueshme me sistemet qe OSHEE ka aktualisht ne përdorim per monitorimin e pajisjeve te rrjetit dhe aplikimin e politikave te sigurise, Cisco Prime dhe Cisco ISE.

3. VDI (Virtual Desktop Infrastructure)

Objekti i furnizimit përfshin mirmbajtjen dhe zgjerimin e infrastruktures aktuale VDI (Virtual Desktop Infrastructure) me qëllim për përmirësimin e sigurisë dhe menaxhimin e centralizuar të përdoruesëve të sistemit të OSHEE Group. Tek Datacenter-i i OSHEE Group do të shtohen burimet procesuese dhe magazinuese të të dhënave. Me anë të kësaj infrastrukture, kompjuteri i çdo punonjësi te zyrave te KNK ku do të implementohet sistemi, do te mund të menaxhohet e kontrollohet nga qendra. Siguria do të rritet, pasi të gjithë të dhënat dhe informacionet e përpunuara nga një përdorues (Thin Client) do të ekzistojnë vetëm në Servera dhe Storage qendrore të ndodhur në Datacenter-in e OSHEE Group sh.a. Kapaciteti i aftësive procesuese të njësive kompjuterike të ndodhura në degët e Oshee sh.a. nëpër qytete ka pasur gjithmonë problematikat e saj për shkak te ngarkesës të sistemit e software-it aplikativ që rritet nga implementimi i funksionaliteteve të shërbimeve të reja, duke sjellë në vazhdimësi furnizimin e shpeshtë me pajisje të reja. Nepermjet VDI e gjithë ngarkesa do të jetë në serverat qendrore, duke e pasur më shumë në kontroll. Në varësi të llojeve të ndryshme të ngarkesave të punës të krijuara, shërbimi mund të sigurohet nga dy infrastruktura të ndryshme fizike dhe elektrike. Infrastruktura duhet të zgjerohet bazuar në një arkitekturë me densitet të lartë, bazuar në teknologjitë e fundit software të virtualizimit të VMware. Ndërlidhja ndërmjet server qendror dhe pajisjeve kompjuterike (Thin Client) që do të marrin shërbimin do të realizohet me ngritjen e një rrjeti VPN Site to Site, për komunikim të sigurtë dhe performancë të lartë. Për këtë është e nevojshme instalimi i pajisjeve router (gateway) në të gjithë institucionet lokale, të cilët duhet të suportojnë protokollet e nevojshme të komunikimit për implementimin e VPN me enkriptim enterprise të sigurtë dhe përmirësimi i pajisjeve router ekzistues në qendrën e OSHEE Group sh.a.

Arkitektura e VDI është e ndërtuar nga komponentët hardware e software, të cilat janë:

- Server qendror që ofron shërbimin e Virtual Desktop.
- Server back-up për sigurinë e vazhdimësisë së sistemit në rastet e dështimit të ndonjë serveri qendror te VDI.
- Server/Storage për ruajtjen dhe aksesimin e të dhënave në rrjet.
- Kompjuter Thin Client, i cili duhet të marrë shërbimin Virtual Desktop.
- Router (Gateway) për ngritjen e rrjetit VPN Site to Site.
- Software virtualizimi.



3.1 FV. Server Rackmount

KARAKTERISTIKAT MINIMALE TEKNIKE

Pikët min për Procesor sipas: cpubenchmark.net	≥ 24000 Pikë (secila cpu)
Numri max i procesoreve:	≥ 2
Procesor te instaluar:	≥ 2

Slote Ram:	≥ 24
Kapaciteti max Ram	≥ 3072 TB
Ram te instaluar:	≥ 320 GB DDR4 ECC
Kapaciteti slote SAS/HDD:	≥ 4
Raid Controller Onboard	Raid 0, Raid 1
“Slots”:	(4) PCI/PCI-E nga të cilat min. (2) PCI-E x16
Portat e Komunikimit	Min. (1) USB 2.0, (2) USB 3.0, (1) VGA, (1) RJ45 Management Rrjeti (onboard) (4) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port, (2) Porta Fiber channel 16Gb/s
Modular PSU	2
Fuqia e PSU	≥ 450W
Hot Plug PSU	Po
Dimensionet:	I montueshem ne Rack 1U
Aksesore	Set instalimi ne Rack

3.2 FV. NAS BackUp 48TB RAW

Karakteristikat Minimale Teknike

- Duhet te suportoje RAID 0, 1, 5, 6, 10, 50, 60
- Pajisja duhet te jete e konvergjuar per perdorim si Storage dhe Application server.
- Shpejtesi te larte komunikimi me 10GbE ose me 40GbE nepermjet kartave shtese.
- Lidhje Remote per menaxhimin e skedarëve në storage lokal, remote dhe cloud.
- Disponueshmeri te larte dhe “Migration” te Virtual Machine duke mundesuar rikuperim te shpejte te operacioneve sa herë që ndodhin dështime në sistemit.
- Duhet te jete me sistem dual controller per te ofruar disponueshmeri ne rastet e deshtimit te nje kontrolleri.
- Stacion Virtualizimi
Virtual Machine (VM) per te perdorur sisteme operative si Windows, Linux, Unix dhe Android
Te suportoje VM import dhe export
VM clone
VM snapshot
VM backup dhe restore
- Stacion Backup
Back-up i planifikuar dhe ne kohe reale
Enkriptim, Kompresim, file Filtrim i skedareve, dhe limit i norms se transferimit
Desktop backup
Backup it e dhenave ne pajisje te shumta magazinimi te jashtme
- Siguria

Mbrojta nga aksesit ne rrjet me bllokimet automatike: SSH, HTTP(S), FTP
 Kontroll aksesit CIFS host per dosjet e shperndara
 Kriptimi te te dhenave bazuar ne volumin 256-bit AES i vertetuar nga FIPS 140-2
 Enkriptim AES 256-bit per hard drive te jashtem

- Specifikime Harduer

CPU core	≥ 6-core, min 1.90GHz
Slote RAM	≥ 8
Memorie RAM	≥ 96 GB
Kapaciteti Max Ram	te suportoje min deri ne 512GB
Kapaciteti Hard Drive	≥ 24x2.5"
Nderfaqja Hard Drive	SAS 12Gb/s
Porta LAN 10/100/1000 Mbps	≥ 6
Porta LAN SFP+ (10 Gbps)	≥ 4
Slote PCIe	≥ 2 (min 1x PCIe Gen3 x8)
Porta USB	≥ 4 (min USB 3.1)
Form Factor	Rackmount (e monueshme ne rack)

Hard Disk te perfshire

Sasia	24 cope
Nderfaqja hard drive	NL SAS
Madhesia	2.5"
Kapaciteti SAS HDD	≥ 2 TB
Shpejtesia e Hard Drive	≥ 7200 rpm

3.3 FV. Upgrade i kapacitetit Storage VDI

Upgrade per ETERNUS DX/200 S4 2.5DE

KARAKTERISTIKAT MINIMALE TEKNIKE

Nderfaqja hard drive	SAS
Madhesia	2.5"
Kapaciteti SAS HDD	≥ 2.4 TB
Shpejtesia e Hard Drive	≥ 10000 rpm

3.4 FV. Upgrade Ram per Server VDI

Upgrade RAM per Server: **PRIMERGY RX2530 M4**

16GB 1Rx4 DDR4-2666 R ECC	PN: S26361-F4026-L216
---------------------------	-----------------------

3.5 FV. Upgrade Licenca Vmware

- Sasia e licencave duhet te jete e mjaftueshme per te mbuluar te gjithë sasine e CPU te instaluar ne serverat e ofertuar ne zerin 3.1
- Software i virtualizimit duhet të sigurojë një shtresë Virtualizimi që operon direkt në (bare metal) hardware server me asnjë varësi nga Sistemet Operative e përgjithshme për besueshmëri më të madhe dhe siguri. (Lloji hypervisor 1.)
- Software i virtualizimit duhet te ofroje disponueshmeri te larte, replication, mbrojtjen e të dhënave dhe te ofroje aftesi sigurie

- Software i virtualizimit do duhet të ketë aftësinë për të lëvizur Makinat Virtuale nga një host në një tjetër pa asnjë downtime në menyre që të sigurohet vazhdimësia e biznesit.
- Software i virtualizimit do duhet të suportoje dhe funksionojë për sistemet operative heterogjene si Windows Server dhe Linux.
- Software i virtualizimit do duhet të sigurojë thjeshtë dhe me kosto efektive backup dhe recovery për makina virtuale të cilat duhet të lejojnë Administratorët për të bërë backup të dhënave virtuale të makinës në disk pa nevojën e agjentëve, kjo zgjidhje rezerve do duhet të ketë built-in gjatësi variabël “de-duplication”
- Software i virtualizimit duhet të jetë i menaxhuar nga platforma aktuale të menaxhimit VMware Vcenter.
- Software i virtualizimit duhet të përfshijë Hypervisor për çdo host/server burimet hardware të të cilit do të virtualizohen.
- Software i virtualizimit duhet të ofrojë mbrojtjen e të dhënave dhe replikim të makinave virtuale
- Software i virtualizimit duhet të ofrojë Fault Tolerance (1 vCPU)
- Garanci për Suport 1 Vit të ofruar nga Prodhuesi i Software VMware

3.6 FV. Deduplication Hardware Appliance

- Zgjidhja duhet të suportohej dhe duhet të integrohet plotësisht me Backup dhe Archive Software egzistues në përdorim EMC Networker.
- Zgjidhja duhet të dergojë në pajisje nepermejt rrjetit duke përdorur protokollet CIFS, NFS, NDMP dhe DD Boost.
- Zgjidhja duhet të suportoje mundësinë e përdorimit të kapacitetit të plotë llogjik si dhe mundësi zgjerimi në të ardhmen.
- Zgjidhja duhet të jetë e montueshme në rack.
- Zgjidhja duhet të përfshijë mundësi transferimi të të dhënave jo më pak se 8 TB/Hr.
- Zgjidhja duhet të ofrojë mundësi rritje të kësaj shpejtësie deri në 24TB/Hr.
- Zgjidhja duhet të ofrojë mundësi për numrin maksimal të Librarive Virtuale dhe Tape që suporton Sistemi i Backup-it.
- Zgjidhja duhet të përfshijë një kapacitet fizik (row-based capacity) jo më pak se 34 TB.
- Zgjidhja duhet të suportoje një kapacitet llogjik jo më pak se 8PB.
- Zgjidhja duhet të përfshijë; 4 x 10 GbE BaseT porta, 2 x 16 GbFC porta 1 x 1 Gb Porte Menaxhimi.
- Zgjidhja dhe kapaciteti i ofruar nga HDD duhet të jetë i mbrojtur me RAID6.
- Zgjidhja duhet të ofrohet me disqe 7.2K rpm, 6G, SAS 2 (Hot Plug).
- Zgjidhja duhet të ketë suport për inline data deduplication.
- Dedublikimi “Deduplication” duhet të kryhet me një madhësi të ndryshueshme blloku (variable block size).
- Përveç dedublikimit “Deduplication”, të dhënat e ruajtura në pajisje duhet gjithashtu të kompresohen.
- Opsionet e algoritmeve të kompresimit që mund të përzgjidhen duhet të jenë lz, gz dhe gz “fast” me kompresim të shpejtë.
- Pajisja duhet të ofrojë mundësi enkriptimi (data-at-rest encryption)

- Zgjidhja duhet të suportoje Global Deduplication (përgjate gjithë hapësirës, midis folderave të ndryshëm, VTL etj në mënyrë që të eliminojë të dhënat e dubluara midis kopjeve.
- Zgjidhja duhet të suportoje verifikimin dhe integritetin të të dhënave të shkruajtura dhe ruajtura në të.
- Zgjidhja duhet të ofrojë replikim në të dy drejtimet burim/destinacion si point-to-point dhe multi-to-one.
- Zgjidhja duhet të përfshijë enkriptim në gjendje normale dhe gjatë replikimit.
- Zgjidhja duhet të përfshijë kompresim të të dhënave.
- Zgjidhja duhet të përfshijë integrim me infrastrukturen virtuale për replikim të të dhënave të plotë të të dhënave dhe jo vetëm në nivel makine virtuale.
- Zgjidhja duhet të suportoje integrim nativ me aplikacionet enterprise (Oracle, Microsoft SQL, SAP, IBM DB2, SAP HANA) duke përdorur plug-in software në aplikacionet e lartpërmendura për të aktivizuar deduplikimin para se të dhënat të transmetohen në destinacionin e ruajtjes. Në këtë rast mund të përdoret dhe Backup-i nativ i vet aplikacionit enterprise.
- Zgjidhja duhet të suportoje arkivimin e të dhënave me mundësi për të ruajtur dhe mbrojtur (retention lock), por licenca për këtë funksion nuk duhet të jetë e përfshirë në ofertë.
- Zgjidhja duhet të përfshijë mundësi e vazhdueshmerisë së shërbimeve në rast prishje të komponenteve si; Burim Ushqimi, Fan, Lidhjet Ethernet, Disqe.
- Zgjidhja duhet të përfshijë rikthim të të dhënave në nivel File-i.
- Zgjidhja duhet të përfshijë një ndërfaqe menaxhimi intuitive si GUI dhe CLI.
- Zgjidhja duhet të përfshijë mundësi paraqitjes së nivelit të kompresimit, shpejtesisë së kalimit të të dhënave, raportime për trafikun në hyrje dhe dalje.
- Zgjidhja duhet të përfshijë gjenerimin e një raporti automatik dhe nderlidhje me qendrën e shërbimeve të prodhuesit.
- Zgjidhja duhet të ofrojë integrim dhe replikim të enkriptuar të të dhënave me sistemin egzistues Deduplication Hardware Appliance EMC DD6300 në primary site.
- Algoritmi i enkriptimit që duhet të suportohet për replikimin e të dhënave midis sistemit egzistues dhe sistemit të ri duhet të jetë AES-128bit.
- Zgjidhja duhet të ketë Garanci min. 1 Vit 24x7x4 të ofruar nga vete prodhuesi.

4. SHËRBIM INSTALIM DHE KONFIGURIMI

4.1 Instalim dhe konfigurim për upgrade/furnizim/vendosje të produkteve në këtë prokurim

Operatori ekonomik duhet të bëjë instalimin dhe konfigurimet që janë ofruar në këtë prokurim duke mos shkaktuar down-time në sistemet kryesore të kompanisë.

SHËRBIMET QË DUHET TË KRYHEN

- **Furnizim, WAN Ruter Tip1/Tip2**
- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi dhe instalimi fizik.
- Implementimi dhe konfigurimi, sipas kërkesave të klientit.

- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit
 - **Furnizim, Switch Core me 24 porta SFP+.**
- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi dhe instalimi fizik.
- Implementimi dhe konfigurimi, sipas kërkesave të klientit.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit
 - **Furnizim, Switch i Menaxhueshëm me 48 porta PoE+ Tip1/Tip2.**
- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi dhe instalimi fizik.
- Implementimi dhe konfigurimi, sipas kërkesave të klientit.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit
 - **Upgrade me licenca Cisco Prime Infrastructure**
- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi i licensave ekzistuese.
- Implementimi dhe konfigurimi i licensave në platformën ekzistuese.
- Konfigurimi i licensave sipas pajisjeve përkatëse.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim të implementimit
 - **Upgrade me licenca CheckPoint VPN/Mobile Remote Access**
- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi i licensave ekzistuese.
- Implementimi dhe konfigurimi i licensave në platformën ekzistuese.
- Konfigurimi i licensave sipas pajisjeve përkatëse.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim të implementimit
 - **Furnizim me software për monitorimin e trafikut në kohë reale**
- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi i licences.
- Implementimi dhe konfigurimi i licences.
- Testimi dhe aksesimi.
- Dokumentim të implementimit
 - **Furnizim me software për video conference dhe online meeting.**
- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi i licences.
- Implementimi dhe konfigurimi i licences.
- Testimi dhe aksesimi.
- Dokumentim të implementimit
 - **Furnizim, Sistemi për informacionin e sigurisë dhe menaxhimin e ngjarjeve**
- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi i licensave.

- Implementimi dhe konfigurimi i licensave.
- Konfigurimi i licensave sipas pajisjeve përkatëse.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim të implementimit
 - **Furnizim, Platforma e levrimit të aplikimeve.**
- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi dhe instalimi fizik.
- Implementimi dhe konfigurimi, sipas kërkesave të klientit.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit
 - **Upgrade, Karte Uplink me 4 porta GE SFP+.**
- Përgatitje e skenarit.
- Verifikim i komponentëve etj.
- Instalimi i moduleve të kartave.
- Testimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit.
 - **Upgrade, Karte rrjeti me 8 porta GE.**
- Përgatitje e skenarit.
- Verifikim i komponentëve etj.
- Instalimi i moduleve të kartave.
- Testimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit.

- **Furnizim, Moduleve/Transceiver të pajisjeve**
- Përgatitje e skenarit.
- Verifikim i komponentëve etj.
- Instalimi i moduleve.
- Testimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit.

Shërbime Instalimi dhe konfigurimi të software, hardware si dhe verifikimi i garancive për suport për periudhën një vjeçare për gjithë produktet në këtë prokurim.

- Përgatitja e skenarit e detajuar për ndërtimin, instalimin, konfigurimin e shërbimeve.
- Përgatitja e skemave të implementimit.
- Testimi i shërbimeve të implementuara.
- Dokumentimi i çdo instalimi, konfigurimi sistemesh: software, hardware.
- Dokumentimi i suportit, mirëmbajtjes së sistemeve të implementuara.

4.2 Shërbime Mirëmbajtje/Suporti Onsite dhe Remote

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumentat standarde të tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 3 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- | | |
|----------|-------|
| 1. _____ | _____ |
|----------|-------|

Dokumentat standarde të tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES Shërbimet – Procedura e Hapur

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2 Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3 Hartimi i Kontratës

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

